



PROCESVERBAL XII/2021

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 12 (dymbëdhjetë) për vitin 2021 të Komitetit për Politikë dhe Financa të
KK Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 21.12.2021
Ora : 10:00

Prezentë:

z. Bexhet Kuçi - Kryesues
z. Urim Suka
znj. Bulëza Kuçi
znj. Sanie Kuçi Rexhepaj
znj. Besa Kuçi
z. Dardan Berisha
z. Liridon Fandaj

Të pranishëm tjerë:

Kryetari i Komunës z. Bali Muharremaj
Habibe Bytyqi - zyrtare për barazi gjinore
Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim
Përfaqësuesi i OSBE-së
Përfaqësuesi i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e të hyrave dhe të dalurave të buxhetit të Komunës së Suharekës për vitin 2021;

Kryesuesi - përshëndet të pranishmit dhe e hedh në votim rendin e ditës.

Liridon Fandaj - nëse kish pas mundësi vendimin e ligjshmërisë së Komisionit, përshkak se ftesa na ka ardhë me datë 14 dhe 15 ditë prej emërimit duhet me pas një vendim të ligjshmërisë. Unë nuk mund të vazhdoj pa këtë vendim.

Avni Bytyqi - përshëndet të pranishmit procesi i planifikimit të buxhetit ka fillu në muajin maj të vitit 2021 dhe deri tani i kemi procedu të gjitha procedurat.

Ai vazhdon më tej me sqarimet si zyrtar ligjor dhe thotë se në aspektin ligjor është në rregull.

Liridon Fandaj - ju thatë që ka kalu në komisionin e kaluar, por buxheti nuk ka kalu në Kuvend Komunal. Edhe ne i kemi organet tjera ku drejtohem për ligjshmërinë.

Avni Bytyqi - mund të vazhdosh. Sipas teje duhet me u kthi në muajin maj me procedurat.

Liridon Fandaj - unë kërkoja sqarim nga Kryesuesi dhe jo nga ju.

Kryesuesi - unë ia dhashë fjalën zyrtarit ligjor për sqarime.

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës.

**6 për, 1 kundër
Miratohet**

Liridon Fandaj lëshon mbledhjen.

Pika 1. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e të hyrave dhe të dalurave të buxhetit të Komunës së Suharekës për vitin 2021;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë në pika të shkurtra se si ka rrjedh çështja e buxhetit dhe hap debatin.

Urim Suka - përshëndet të pranishmit. Ky buxhet as interesat elementare të qytetarëve nuk i përfaqëson. Ne mendojmë që ky buxhet duhet të kthehet, të përgatitet më mirë, që ti përfaqësoj interesat e qytetarëve. Nëse e dërgoni në Kuvend ne do ti themi arsyet tona atje, se pse nuk duhet të votohet. Nuk e them këtë që të bëj opozitë, por vërtetë është fyerje sepse ka plot rrugë për vitin 2022 e që në teren janë të shtruara. Ju kisha lutë që mos ta kalojmë për Asamble por të rishqyrtohet.

Dardan Berisha - përshëndet të pranishmit. Është bo standard që buxheti i fundit të mos votohet. Ky buxhet është mbajt pak peng nga opozita sepse është mundu në një formë ta përdorë politikisht, por gjithsesi edhe pozita ta përdorë politikisht. Te të hyrat komunale për vitin 2022 ka rritje. Ne do ta qesim veten në rolin e të zgjedhurit të qytetarëve dhe jo të subjekteve politike. Nëse ky buxhet nuk kalon, ne e kemi parasysh që punëtorët e Hendikosit dhe të Karitasit mbesin pa paga. Në një të ardhme kërkoj që të kemi një bashkëpunim të mirëfillt. Ka disa projekte të cilat figurojnë dhe janë të përfunduara, ato duhet të rishikohen, por gjithsesi vota ime është pro.

Kryesuesi - siç e cekim edhe Dardani, çdo vit zgjedhor i ka anët negative dhe pozitive sa i përket miratimit të buxhetit, mirëpo unë personalisht kamë qenë në 40 takime me ekzekutivin dhe i kemi marrë të gjitha prioritetet nëpër fshatra.

Urim Suka - nuk jam kundër miratimit, por buxheti është për keqardhje. Kemi premtu ujë në Bllacë dhe asnjë euro nuk e kemi parapa për ujë në fshatin Bllacë. Kërkesat që kanë pas qytetarët, ato vendosni në buxhet. Dardani po merr një risk shumë të madh dhe sa kam informacione Dardani ka qenë kundër buxhetit herën e parë.

Kryetari - përshëndet të pranishmit. Çdo herë i kemi thirrë përfaqësuesit e partive politike pa u formu korniza. Sa i përket ujit kemi pas marrëveshje me qeverinë zvicerane. Kemi fillu me punë edhe për ujë në shumë fshatra.

Dardan Berisha - pse kam qenë kundër dy vendimet e fundit, e thashë dhe më herët. Është bo standard që buxheti për vitin e fundit të përdoret për fushat çoftë nga pozita dhe çoftë nga opozita. Do ta votoj pro.

Urim Suka - çështja e Bllacës, ishte vetëm si shembull.

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor sqaron që ky buxhet në KPF ka kalu mandatin e kaluar, dhe kjo ka qenë për hirë të transparencës që ju si anëtarë të rinjë të njoftoheni paraprakisht me buxhetin.

Urim Suka - më pengon tendenca që ju drejtoheni ndaj meje dhe mendoni që bëj opozitë, por buxhetin e kemi për keqardhje.

Kryesuesi - e hedh në votim.

**4 për, 2 kundër
Miratohet**

Takimi përfundoi: 10:25

**Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj**